

KËRKESAT METROLOGJIKE PËR SHISHET ENËMATËSE

Informacion për operatorët ekonomikë

Kjo broshurë jep informacion mbi kërkesat metrologjike të shisheve enëmatëse që kontrollohen ligjërisht, mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në to, për të garantuar saktësinë e kapacitetit mbajtës të tyre.

Pse duhen kërkesat metrologjike të shisheve enëmatëse?

Shishet enëmatëse janë enë që përdoren për peshimin e saktë të lëngjeve. Përcaktimi i kërkesave të detyrueshme metrologjike mundëson saktësinë e kapacitetit që këto enë duhet të kenë, në përputhje me informacionin e treguar mbi to. Respektimi i këtyre kërkesave garanton mbrojtjen e interesave ekonomikë të konsumatorëve nga rezultatet e pasakta, si edhe transparencën e tregut dhe ndershmërinë ndërmjet operatorëve ekonomikë që prodhojnë, tregtojnë apo përdorin shishe enëmatëse në veprimtarinë e tyre tregtare.

Ku mund të merret informacion për parashikimet ligjore:

Kërkesat për prodhimin dhe tregtimin e shisheve enëmatëse janë të përcaktuara në rregulloren "Për shishet enëmatëse" i miratuar me VKM-në nr.349/2021, si edhe ligjin nr.126/2020 "Për metrologjinë". Ato parashikojnë kërkesat e detyrueshme metrologjike ndaj shisheve enëmatëse që kontrollohen ligjërisht, mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në to, si edhe metodat referuese për kontrollin e vëllimit neto të tyre.

Cilat konsiderohen shishe enëmatëse?

Shishet enëmatëse janë enë, të quajtura shishe prej qelqi ose prej ndonjë materiali tjetër, që kanë fortësinë dhe qëndrueshmërinë e tillë për të ofruar garanci metrologjike si qelqi.

Këto enë:

- kanë kapacitet mbajtës nga 0.05 litra deri në 5 litra, përfshirë edhe këto dy vlera;
- janë të taposura ose të destinuara për t'u taposur, të destinuara për magazinimin, transportin ose shpërndarjen e lëngjeve;
- kanë karakteristika metrologjike (të projektimit dhe prodhimit) të tilla që mund të përdoren si shishe matëse, kur ato mbushen në një nivel të caktuar dhe kështu përmbajtja e tyre mund të matet me një saktësi të mjaftueshme.

Kapaciteti i shisheve enëmatëse

Kapacitetet e shisheve enëmatëse përcaktohen gjithmonë në temperaturën 20°C dhe përfshijnë:

- Kapacitetin nominal V_n , që është vëllimi i shënuar në shishe; ai tregon vëllimin e lëngut që shishja konsiderohet të përmbajë, kur mbushet në kushtet e përdorimit ashtu siç është destinuar.
- Kapacitetin "deri në buzë" është vëllimi i lëngut që përmban kur mbushet deri në buzë.
- Kapaciteti i vërtetë (ose aktual) i shishes është vëllimi i lëngut që në fakt ajo përmban kur mbushet saktësisht në kushtet që i përputhen kapacitetit nominal

*Gabimet maksimale të lejuara të shisheve enëmatëse janë të mirëpërcaktuara në VKM-në nr.349/2021.

*Shfrytëzimi sistematik i tolerancave në prodhimin e shisheve enëmatëse, është i ndaluar!

Konformiteti i shisheve enëmatëse

Shenja e konformitetit mund të vendoset nga prodhuesi për të vërtetuar se shishet enëmatëse përputhen me kërkesat metrologjike të përcaktuara.

Shenja e konformitetit është një shkronjë "epsilon" e rrotulluar simetrikisht në aksin vertikale, dhe duhet të ketë të paktën 3mm lartësi.

3



Mbishkrimet në shishe enëmatëse

Të gjitha mbishkrimet mbi shishe enëmatëse duhet të vendosen në mënyrë që të mos dëmtohen ose shuhen, të jenë lehtësisht të lexueshme dhe të dukshme në kushte normale të paraqitjes.

Një shishe enëmatëse duhet të mbajë në një anë të saj, në fund ose në rrethin e fundit:

- një mbishkrim tregues për kapacitetin nominal të saj në shkronja të ndjekur nga simboli e njësive së matjes së përdorur;
- shenjë e identifikimit të prodhuesit;
- shenjë "a";

Një shishe enëmatëse do të mbajë në fund ose në rrethin e fundit, në përputhje me metodën ose metodat e mbushjes për të cilën është ideuar:

- një mbishkrim tregues për kapacitetin "deri në buzë", të shprehur në centilitra dhe të pandjekura nga simboli cl.
- dhe/ose një mbishkrim tregues në milimetra të distancës nga niveli "deri në buzë" deri të niveli i mbushjes që i përket kapacitetit nominal, i ndjekur nga simboli mm.



*Prodhuesit mund të vendosin edhe tregues të tjerë në shishet enëmatëse, me kusht që këto të mos krijojnë konfuzion me treguesit kryesorë.

Detyrimet e operatorëve ekonomikë

- ✓ Prodhuesi ose importuesi është përgjegjës për përputhshmërinë e shisheve si enë matëse me kërkesat metrologjike.
- ✓ Çdo prodhues i shisheve enëmatëse, i regjistruar në Shqipëri, duhet të aplikojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për miratimin e shenjes me anë të së cilës ai identifikohet. Prodhuesi, nën përgjegjësinë e tij, vendos shenjen e konformitetit "a" për të vërtetuar se shishet përputhen me kërkesat e kësaj rregulloreje.
- ✓ Prodhuesi zbaton sistemin e kontrollit të vëllimit neto të shisheve të prodhuara.
- ✓ Çdo operator ekonomik (importues apo përfaqësues i autorizuar i prodhuesit) duhet të vendosë në tregun shqiptar vetëm shishe enëmatëse që janë në përputhje me kërkesat metrologjike të përcaktuara dhe që kanë mbishkrimet dhe shenjat e përshkruara deri në kohën e blerjes.
- ✓ Prodhuesi ose importuesi, kur konstaton se shishet si enë matëse të vendosura në treg prej tij nuk përmbushin kërkesat ligjore të përshkruara, merr masat e duhura për mbrojtjen e konsumatorit në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Mbrojtjes së Tregut.

Kontrolli metrologjik i shisheve enëmatëse

Shishet enëmatëse që prodhohen apo tregtohen në Shqipëri, janë objekt i kontrollit metrologjik nga Inspektorati Shtetëror i Mbrojtjes së Tregut.

Kontrolli kryhet për të verifikuar saktësinë e treguesve metrologjicë, duke përdorur metodat referuese shkencore të mirëpërcaktuara në VKM-në nr.349/2021.

Në rast konstatimi të tregimit të shisheve enëmatëse në kundërshtim me kërkesat metrologjike, merren masa përkatëse duke filluar nga vendosja e gjobave deri tek ndalimi i vendosjes në treg apo heqjen nga tregu të shisheve enëmatëse.



Implemented by
giz
Cooperation International
GIZ - GERMANY



Publikim i mundësuar nga projekti "Mbështetje për Negociatat e Anëtarësimit në Kapitujt Ekonomikë të Acquis" (SANECA) financiar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim dhe zbatuar nga GIZ Shqipëri.

Përmbajtja e kësaj broshure ka karakter informues. Detyrime ligjore të plota jepen në aktet ligjore të përmendura në brendësi të broshurës.

